



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1168/7 prot

Datë 27.05.2024

**V E N D I M**

**Nr. 567/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.05.2024 me

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-00117-04-04-2024, me objekt: “*Blerje pajisje printimi për KESH Qendër dhe Njësitë e Prodhimit*” me fond limit 15,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 22.04.2024, nga autoriteti kontraktor, KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitiko Shqiptare).

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “RIKON-AL” SHPK & “QuantX IT Solutions” SHPK në procedurën e mësipërme tëprokurimit.

**Autoriteti Kontraktor:**

KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitiko Shqiptare)  
Rruga “Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK,  
me NUIS J61817047D, me adresë: Bulevardi Zhan D'ark,  
Nd.32, Hyrja 16, Kati 2, Ap.1, Tiranë

BOE “RIKON-AL” SHPK & “QuantX IT Solutions” SHPK, përkatësisht me NUIS L22119010H, NUIS M31904013D dhe adresa: Njesia Administrative Kashar, Tiranë; Rruga “Ismail Qemali”, ND.40, H. 28, 1050, Yzberisht, Tiranë.

**Subjekte të Interesuara:**

Operatori ekonomik “C.C.S” SHPK me NUIS J61901033C dhe adresë: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga “Sulejman Delvina”, nr.8, kodi postar nr.1019, Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi Paraparak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraparak të ankesave të mbështetura në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 05.04.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF- 00117-04-04-2024, me objekt: “Blerje pajisje printimi për KESH Qendër dhe Njësitë e Prodhimit ” me fond limit 15,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 22.04.2024 nga autoriteti kontraktor, KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitiko Shqiptare).

II.2. Në datën 29.04.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit përfundimtar të ofertave, përkatësisht:

- |                            |                               |
|----------------------------|-------------------------------|
| 1. “BNT Electronics” SHPK, | 7.497.000 lekë, skualifikuar  |
| 2. “Rikon-AI” SHPK         | 11.250.000 lekë, skualifikuar |
| 3. “C.C.S” SHPK            | 13.787.000 lekë, kualifikuar  |

Operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK, është njohur me arsyet e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, me argumentet si më poshtë vijon:

#### **Arsyet e skualifikimit:**

*OE BNT Electronics ka paraqitur ofertë ekonomike anomalisht të ulët. OE skualifikohet në zbatim të nenit 93 pika 5 të ligjit 162/2020, i ndryshuar, e cila citohet se: 5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.*

Operatori ekonomik “Rikon-AI” SHPK, është njohur me arsyet e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, me argumentet si më poshtë vijon:

#### **Arsyet e skualifikimit:**

*“Formulari i ofertës i paraqitur nga BOE Rikon-AL sh.p.k L22119010H (90%) & QuantX IT Solutions sh.p.k (10%) M31904013D është në kundërshtim me dokumentet e tenderit. Është paraqitur formular oferte sipas DT shërbime si dhe Lista e çmimeve të shërbimeve ndërkohë që procedura është procedurë mallrash.*

*-Në kërkesën e AK është kërkuar që ofertuesi duhet të paraqesë 8 copë printera MFP A4/A3 Color 30ppm + Set Toneri nga BOE janë ofertuar 5.*

*-Në kërkesën e AK është kërkuar që ofertuesi duhet të paraqesë 5 copë printera MFP A4/A3B&Ë 30ppm + Set Toneri nga BOE janë ofertuar 8.*

*Oferta ekonomike është plotësuar në kundërshtim me specifikimet teknike.*

II.4. Në datën 07.05.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit. Ofertuesit ankimues janë njoftuar edhe njëherë për arsyet e skualifikimit si vijon:

1- Operatori Ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k, NIPT J61817047D, pasi ka paraqitur ofertë ekonomike anomalisht të ulët.

Në zbatim të nenit 93 pika 5 të ligjit Nr.162 datë 23/12/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar citohet se:

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët”.

2- Bashkimi operatorëve ekonomik “Rikon - AL” sh.p.k, NIPT L22119010H (90%) & “QuantX IT Solutions” sh.p.k, NIPT M31904013D (10%) pasi:

✚ Formulari i ofertës i paraqitur nga bashkimi operatorëve ekonomik “Rikon – AL” sh.p.k, NIPT L22119010H (90%) & “QuantX IT Solutions” sh.p.k, është në kundërshtim me dokumentat e tenderit. Është paraqitur formular oferte sipas DST shërbime si dhe Lista e çmimeve të shërbimeve ndërkohë që procedura është procedurë mallrash.

✚ Në kërkesën e Autoritetit Kontraktor është kërkuar që ofertuesi duhet të paraqesë 8 (tetë) copë printera MFP A4/A3 Color 30ppm + Set Toneri. Nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Rikon - AL” sh.p.k & “QuantX IT Solutions” sh.p.k, janë ofertuar 5 (pesë) copë printera. Oferta ekonomike është plotësuar në kundërshtim me specifikimet teknike.

✚ Në kërkesën e Autoritetit Kontraktor është kërkuar që ofertuesi duhet të paraqesë 5 (pesë) copë printera MFP A4/A3B&W 30ppm + Set Toneri. Nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Rikon - AL” sh.p.k & “QuantX IT Solutions” sh.p.k, janë ofertuar 8 (tetë) copë printera. Oferta ekonomike është plotësuar në kundërshtim me specifikimet teknike.

II.5. Në datën 13.05.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4078 protokolluar me nr. 1168/2024 protokolli, datë 13.05.2024, e operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF- 00117-04-04-2024, me objekt: “Blerje pajisje printimi për KESH Qendër dhe Njësitë e Prodimit ” me fond limit 15,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 22.04.2024, nga autoriteti kontraktor, KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitiko Shqiptare).

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1168/2 prot, datë 14.05.2024 me arsyet e skualifikimit, të cilat kundërshtohen nga ankimuesi. Konkretisht në ankesë pretendohet si vijon:

“[...]

Me poshte do te gjeni argumente dhe prova te cilat edhe pse oferta jone rezulton anomalisht e ulet, perseri eshte nje oferte e vlefshme dhe qe garanton plotesisht zbatimin e kontrates me nje cmim dhe cilesi sipas kerkesave te AK.

Korporata Elektroenergjitiqe Shqiptare ka kerkuar te prokuroje pajisjet produktet si me poshte:

Nr.	Pershkrimi i produkteve	Sasia/cope
1	MFP A4/A3 Color 30ppm + set toneri	8
2	MFP A4/43 B&W 30ppm + Toner	5
3	MFP A4/A3 B&W 55ppm + Toner	5
4	Software Menaxhimi	1

Pra ne total, Ak kerkon te prokuroje 18 cope pajisje Multifunksionale (printuese/fotokopjuese) dhe nje program menaxhimi per pajisjet.

Lidhur me keto pajisje, AK ka parashikuar parametrat teknike, pjese e DST ku verehet se jane pajisje me nje konfigurim standard, pra nuk ka ndonje karakteristike te vecante qe mund te coje ne nje oferte ekonomike relativisht te larte. Gjithsesi, referuar LPP 162/2020, neni 93 i Oferta Anomalisht e Uletë, pika 2 ku parashikon: Shpjegimet e përmendura, jepen veaanërisht për: a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës; c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; a) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës; d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

BNT Electronics SHPK, jep shpjegime dhe prova te cilat provojne se oferta jone eshte e vlefshme dhe qe garanton realizimin e kontrates.

A) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; lidhur me kete kusht, ju bejme me dije se produktet e ofertuara nga BNT Electronics SHPK ne ket procedure, jane te gjitha produkte te Markes Kyocera te cilat i ofertojme ne kete procedure duke marre Autorizim nga Distributori direkt i Kyoceres ne Shqiperi, ne kete rast kompania BT Solution. Eshte lehtesisht e kuptueshme se cmimet qe siguron distributori direkt i Kyoceres jan cmime shume konkruuese ne treg. Gjithashtu, duke qene se shoqera BNT Electronics SHPK dhe shoqeria BT Solution kane bashkepunime nder vite, nje marredhenie thua jse 20 vjecare se bashku, kjo e fundit sigurisht qe ka dakortesuar nje cmim teper konkurrues per shoqerine tone, me qellim qe te kryesojme ne kete procedure.

Me poshte, po ju paraqesim analizen e detajuar te kosatos, te cilen per arsye konfidencialiteti, kerkojme te mos publikohen cmimet:

1. Kosto fikse: Pajisjet + software menaxhimi qe blihen nga BT Solution, totali: XXXXXXXX  
Leke, si ne tabelen me poshte:

Nr.	Pershkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njësi pa TVSH	Vlera pa TVSH
1	A4/A3 Color 30ppm Kyocera TASKalfa3554ci + toner				cope 8

2	A4/A3 B&W 30ppm Kyocera TASKalfaMZ3200i+ toner cope	5	199,000
3	A4/A3 B&W 55ppm Kyocera TASKalfa6004i+ toner cope	5	199,000
4	Software Manaxhimi MyQ/KNMcope	1	199,000
Vlera totale pa TVSH Lek			

2. Kosto Variable nuk ka pasi nuk eshte furnizim sherbimi: 0 %
3. Kosto Operative: 0 %
4. Fitimi: 0 %

*Pervec se kjo pike eshte e provuar me analizen e kostos, sjellim ne vemendjen tuaj se ne kemi ofertuar dhe realizuar disa kontrata te ngjashme ne institucione publike dhe private te cilat i kemi perseri pajisjet nga kyocera dhe do vereni qe gjenden perafersisht te njejtat cmime me keto te ofertuara ne kete procedure. Bashkengjitur gjeni edhe vertetime realizimi/fatura me privatim per furnizime te ngjashme.*

*Theksojme se me keto cmime te peraferta kemi ofertuar edhe ne AKSH dhe nuk kemi rezultuar me oferte anomalisht te ulet pasi keto jane cmime reale. Ne kete rast, kemi rezultuar me oferte anomalish te ulet vetem per arsye se konkurentet e tjere kan ofertuar shujme shtrenjt per te shfrytezuar sa me shume fondin e vene ne dispozicion.*

*B) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës; Shoqeria BNT Electronics shpk, eshte shoqeri lider ne fushen e tregimit te pajisjeve elektronike qe operon prej 30 vitesh ne ket treg, pra qe ne vitin 1994, nder shoqerite tregtare te parat ne vend. Duke qene e tille, eshte e kuptueshme qe per shkak te experiences tone me partner te ndryshem ne mbare boten qe na furnizojne me pajisje te ndryshme, (prodhuesit me te fuqishem dhe te njohur te pajisjeve) sigurisht qe ne kemi ofertuar nje zgjidhje teknike qe perputhet me kerkesat e AK te percaktuara ne DST por pervec kesaj eshte edhe kushti favorizues qe kemi per te marre cmime teper konkuruese direct nga distributori i kompanise Kyocera ne Shqiperi.*

*Marredhenia jone direkte qe kemi patur me Kyoceren si dhe marredhenia qe kemi nder vite me distributorin e Kyoceras, ne kete rast BT Solution, sigurisht qe mundeson cmime teper konkuruese dhe fituese ne treg pasi kjo e fundi, ne momentin qe dakorteson me kompanine tone per shitjen e produkteve, aplikon per veten nje marzh fitimi teper te ulet, thuaje te pa konsiderueshem dhe nga ana tjeter edhe vete ne BNT Electronics shpk, aplikojme nje marzh fitimi jo shume te larte, pra brenda normave dhe sigurisht qe ky fakt ndikon drejtepersedrejti ne vleren perfundimtare te paraqitur ne oferten tone. Per te provuar kete kusht, ne do te ju vendosim ne dispozicion marreveshjen qe kemi me BT Solution per blerjen e produkteve te ofertuara ne kete procedure. Aty do te gjeni te detajuara cmimet e dakortesuara per blerjen e ketyre produkteve te cilat per shkak te konfidencialitetit kerkojme qe te mos publikohen keto cmime. Theksojme se me keto cmime te peraferta kemi ofertuar edhe ne AKSH dhe nuk kemi rezultuar me oferte anomalisht te ulet pasi keto jane cmime reale. Ne kete rast, kemi rezultuar me oferte anomalish te ulet vetem per arsye se konkurentet e tjere kan ofertuar shujme shtrenjt per te shfrytezuar sa me shume fondin e vene ne dispozicion. Gjithashtu per reference, bashkengjitur do te gjeni edhe Fatura blerje te BT Solution nga Kyocera per pajisje te nivelit teknik te ngjashme dhe aty do te gjeni perseri cmimet e ngjashme*

qe furnizohet BT Solution nga Kyocera edhe keto per shkak te konfidencialitetit kerkojme te mos publikohen.

C) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; lidhur me kete kusht ju bejme me dije se produktet Kyocera te ofertuara ne kete procedure jane origjinale te prodhuara nga Kyocera. Ky fakt eshte lehtesisht i provueshem pasi nje nder kriteret kualifikuese te parashikuara ne DST ishte edhe paraqitja e Autorizimit te Prodhuesit ose Autorizim nga Distributori ku provohet lidhja me prodhuesin. Per permbushjen e ketij kriteri ne kemi paraqitur Autorizimin nga BT Solution, distributor i vetem ne Shqiperi per kompanine Kyocera si dhe shoqeruar me dokumentin qe verteton lidhjen, pra me Autorizimin e Prodhuesit te Kyoceras per BT Solution. Gjithashtu nje kriter tjetër për te garantuar origjinalitetin e furnizimeve qe ishte parashikuar edhe ne DST, ishte edhe kriteri per paraqitje te marreveshjes me prodhuesin ose me distributorin e prodhuesit ku te vertetohet lidhja me kete te fundit. Ne permbushje te ketij kriteri ne kemi paraqitur marreveshjen qe kemi bere me distributorin lidhur me mirembajtjen si dhe marreveshjen qe ka distributoiri me prodhuesin lidhur me kushtet e mirembajtjes.

Pervec sa me larte, sjellim ne vemendjen tuaj se shoqeria BNT Electronics shpk, eshte nje shoqeri qe ka standarte te larta te ofrimit te sherbimeve, eshte shoqeri e certifikuar me standarte te larta sic eshte : certifikim ISO 2000 per menaxhimin e sherbimit te teknologjise se informacionit; ISO 9001 per cilesine e produkteve dhe sherbimeve; ISO 22301 per vazhdimesine e biznesit; ISO 27001 per sistemin e menaxhimit te sigurise se informacionit dhe shume certifikime te tjera. Pra eshte mese e kuptueshme dhe e provuar se BNT Electronics shpk garanton realizimin e objektit te kesaj kontrate, origjinalitetin e produkteve dhe sherbimeve. Gjithashtu, nje fakt tjetër i rendesishem eshte fakti se ne kete procedure prokurimi eshte kerkuar edhe qe OE te Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, për periudhën Shkurt 2024 - Mars 2024, një minimum punonjësish të certifikuar për:

- Jo më pak se 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për paisjet fotokopje multifunksionale ose institucione certifikuese të autorizuar;
- Jo më pak se 1 (një) punonjës të certifikuar për rrjetet;
- Jo më pak se 1 (një) punonjës të certifikuar për platformën Microsoft (Microsoft 365, Server) ose ekuivalent.

Ne lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit

Ne permbushje te kerij kriteri ne kemi plotesuar Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit ku kemi deklaruar certifikimet perkatese, konkretisht: 4 persona ne nivel teknik dhe inxhinierik te certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve, pra nga Kyocera, nje person ne nivel inxhinierik te certifikuar per rrjetet dhe nje person tjetër ne nivel inxhinieri te certifikuar per platformen Microsoft.

Ky staf ne nivel teknik/inxhinierik si dhe te certifikuar nga prodhuesi Kyocera, si dhe pjesa tjetër e stafit te certifikuar nga organizmat e lejuara ne tender, garantojne sherbime origjinale pasi sherbimi i pajisjeve do te kryhet sipas trajnimeve te bera nga vete prodhuesi i produkteve te ofertuara. Bashkengjitur do te gjeni Formularin permbledhes te Vetedeklarimit, te gjitha



marreveshjet, autorizimet dhe certifikimet ISO te permendura ne kete pike. C) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës; Shoqeria BNT Electronics shpk, është një shoqëri e rregullt që paguan të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit dhe në fushën sociale dhe të punës. Lidhur me detyrimet që rrjedhin në fushën e mjedisit, BNT aplikon standarte të larta, madje është e certifikuar edhe me standartin ISO 14001 për mbrojtjen e mjedisit në vendet ku ushtrohet aktivitetet apo shërbimet. Gjithashtu lidhur me detyrimet që rrjedhin në fushën sociale dhe të punës, shoqeria BNT Electronics shpk jo vetëm që paguan të gjitha sigurimet sociale dhe shëndetësore dhe cdo detyrim që lidhet me këto fushë por gjithashtu BNT aplikon standarte të larta dhe është certifikuar me standartet ISO 18001 dhe ISO 45001 për sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë. Bashkëngjitur do të gjeni vertetim për shlyerjen e detyrimeve si dhe certifikimet ISO të lartepërmendura.

D) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore. Shoqeria BNT Electronics shpk, asnjehere në 30 vite experience nuk ka marrë ndihmë shtetërore. Shoqeria BNT ka xhiron e tre viteve të fundit si me poshte:

- Periudha tatimore 2023: XXX XXX XXX Leke
- Periudha tatimore 2022: XXX XXX XXX Leke
- Periudha tatimore 2021: XXX XXX XXX Leke

Prove kjo që provon kapacitetin ekonomik të shoqërisë dhe që nuk ka ekzistuar nevoja për të marrë ndihmë shtetërore. Gjithashtu, bashkëngjitur do të gjeni edhe Bilancet të shoqëruara bashkë me raport auditiv ku pasqyrohet xhiro dhe fitime si dhe cdo aspekt tjetër financiar i kompanisë. Me këto dokumente provohet se BNT Electronics shpk nuk ka marrë ndihmë shtetërore, përndryshe ky fakt do të ishte pasqyruar në bilanc.

Pra në thelb, referuar ofertes tonë e cila në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, kemi paraqitur sqarime dhe dokumentacion të plotë që argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar), duke e provuar me dokumentacion se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Referuar LPP, neni 80 Parimet e procesit të përzgjedhjes: 1. Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme: a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura; b) operatori ekonomik, që ka dorëzuar ofertën, përmbush kriteret e kualifikimit të përzgjedhjes dhe nuk ndodhet në ndonjë nga situatat që përbëjnë shkak për skualifikim.

Edhe në këto rast rezulton se oferta e paraqitur nga BNT Electronics shpk, plotëson këto kriterë. Në kuadër të vete qëllimit të LPP, ku ndër qëllimet është edhe të sigurojë mirepërdorim të fondeve dhe të ulë shpenzimet si dhe të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, Ak duhet të kualifikojë ofertën e paraqitur nga BNT Electronics SHPK pasi kemi paraqitur sqarime dhe dokumentacion të plotë që argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar), duke e provuar me dokumentacion se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një



*kontrate të suksesshme. Per sa me larte, kerkojme: - kualifikimin e ofertes tone si oferte e qe ploteson te gjitha kriteret e vendosura ne dokumentacionin e tenderit me cmimin me te ulet dhe ne perputhje te plote me legjislacionin e prokurimit publik.”*

II.5.2. Në datën 16.05.2024, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1168/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 2211/2 prot., datë 16.06.2024, me objekt: “Vendim për shqyrtimin e ankesës për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje pajisje printimi për KESH Qendër dhe Njësitë e Prodhimit”, Nr.Ref-00117-04-04-2024”, ardhur nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, bashkëngjitur relacioni për shqyrtimin e ankesës me nr. 2211/1 prot., datë 16.05.2024.

Referuar këtij vendimi dhe relacionit për shqyrtimin e ankesës, rezulton, se autoriteti kontraktor ka refuzuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “BNT Electronics” SHPK, duke argumentuar si vijon:

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi u njoh me pretendimet e ankimuesit “BNT Electronics” sh.p.k, relaton si më poshtë:*

***Së pari (Ratione temporis):*** Ankesa është paraqitur brenda afatit të përcaktuar në Nenin 110 të Ligjit 162, datë 23/12/2020, i ndryshuar dhe si e tillë pranohet të shqyrtohet nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës.

*Së dyti (Legjitimiteti i ankuesit dhe forma e ankesës):* Ankesa është paraqitur nga personi i interesuar sipas forinstit të kërkuar në Nenin 111 të Ligjit 162, datë 23/12/2020, i ndryshuar dhe si e tillë pranohet të shqyrtohet nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës.

***Në lidhje me pretendimin e ankimuesit për ofertën anomalisht të ulët, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave relalon si më poshtë vijon:***

*Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) rezulton se Operatori Ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k, NIPT J61817047D, ka ofertuar ofertën ekonomike me vlerë 7,497,000 (Shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) Lekë pa TVSH. Nga verifikimet e kryera rezulton se kjo ofertë është konstatuar anomalisht e ulët.*

*Në zbatim të ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 27 citon se:*

***Në nenin 93, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:***

***5. “Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime në ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët”.***

*Referuar sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon, se operatori ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k, nuk plotëson kriterin e vecantë të kualifikimit, pasi subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi.*

*Bazuar sa me siper, pretendimi i ankimuesit per kualifikimin e ofertes si oferte qe ploteson te gjitha kriteret e vendosura ne dokumentacionin e tenderit me çmimin me te ulet dhe ne perputhje te plote me legjislacionin e prokurimit Publik **nuk qendron.***

II.6. Në datën 13.05.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4079, protokolluar me nr. 1169/2024 protokollin, datë 13.05.2024, e BOE “RIKON-AL” SHPK & “QuantX IT Solutions” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-00117-04-04-2024, me objekt: “Blerje pajisje printimi për KESH Qendër dhe Njësitë e Prodhimit” me fond limit 15,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22.04.2024 nga autoriteti kontraktor, KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitiko Shqiptare).

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “RIKON-AL” SHPK & “QuantX IT Solutions” SHPK.

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1169/2 date 14.05.2024, me arsyet e skualifikimit që BOE “RIKON-AL” SHPK & “QuantX IT Solutions” SHPK, kundërshton me anë të ankesës me nr. 11692 date 13.05.2024.

Konkretisht në ankesë pretendohet si vijon:

[...]

*Pretendimi i Pare Oferta e jone nuk eshte kualifikuar per gabime shtypi! Ne arsyetimin e tij AK nuk ka kualifikuar oferten tone per pretendimin e meposhtem:*

*-Formulari i ofertës i paraqitur nga BOE Rikon-AL sh.p.k L22119010H (90%) & quantx IT Solutions sh.p.k (10%) M31904013D është në kundërshtim me dokumentet e tenderit. Eshtë paraqitur formular oferte sipas DT shërbime si dhe Lista e Cmimeve të shërbimeve ndërkohë që procedura është procedurë mallrash.*

*Oferta ekonomike e paraqitur nga ana jone si me poshtë:*

**Shtojca 2.**

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHERBIMEVE**

**Data: 22/04/2024**

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: REF- 00117-04-04-2024**

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): BOE RIKON-AL shpk L22119010H & QuantX IT Solutions shpk M31904013D**

**Monedha: Lek**

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

*Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Sherbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për sherbimet. Sherbimet pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.*

**Lista e Çmimeve**

1	2	3	4	6
Sherbimi	<u>Përshkrimi i sherbimit</u>	Sasia	cmimi per njesi	Çmimi total për sherbim (3 x 4X)
1	MFP A4/A3 B&Ë 30ppm + Set Toner	8		
2	MFP A4/A3 Color 30ppm + Set Toneri	5		
3	MFP A4/A3 B&Ë 55ppm + Set Toner	5		
4	Softëare Manaxhimi + ËIN Server	1		
<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>				
<b>TVSH (%)</b>				
<b>Çmimi total me TVSH:</b>				
<b>Emri i përfaqësuesit BOE RIKON-AL shpk L22119010H &amp; QuantX IT Solutions shpk M31904013D</b>		<b>AGON MAKOLLI</b>		
<b>Vula</b>				
<b>Datë 22/04/2024</b>				

*Oferta ekonomike përmban gabime shtypi, të cilat në asnjë rast nuk ndryshojnë thelbin e ofertës. Këto gabime nuk sjellin asnjë konfuzion për Autoritetin Kontraktor rreth përmbajtjes së ofertës dhe për më tepër, janë plotësisht të mbështetura nga dhjetëra dokumente të tjera të paraqitura gjatë procedurës. Këto dokumente qartësisht konfirmojnë qëllimin tonë për ofertimin e mallrave, sic e dëshmojnë edhe përshkrimet e detajuara të artikujve, sasive dhe katalogëve të përfshirë në ofertë. Është evidente dhe e dukshme se bëhet fjalë për një gabim shtypi. Vendimi i Autoritetit Kontraktor për përjashtimin e ofertës sonë shfaq një kundërshtim të hapur me Ligjin mbi Prokurimin Publik dhe, për më tepër, përbën një veprim diskriminues, i cili është përsëritur në mënyrë të qëllimshme dhe sistematike nga ana e KESH SH.A.*

*Oferta jonë ekonomike, sic theksoni, përmbante një listë të shërbimeve në vend të një liste mallrash. Ky gabim, megjithëse paraqet një devijim nga formati i kërkuar i ofertës, duhet vlerësuar në kontekstin e Ligjit mbi Prokurimin Publik, vecanërisht neni 92 pika 3, i cili pranon tolerancën për gabimet që nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Konsiderojmë që gabimi ynë duhet të kategorizohet si gabim shtypi dhe si devijim i vogël që mund të korrigjohet pa ndryshuar thelbin e ofertës sonë. Ligji parashikon qartë se një ofertë nuk duhet të përjashtohet nëse gabimet e tilla nuk prekin përmbajtjen substanciale të asaj që ofrohet. Ne bazë të argumenteve të paraqitura dhe të nenit përkatës të Ligjit mbi Prokurimin Publik, kërkojmë ndryshimin e vendimit dhe kualifikimin e ofertës sonë!*

**Pretendimi i dyte.**

*Oferta e jone nuk eshte kualifikuar per gabime shtypi dhe jo substanciale!*

*Ne arsyetimin e tij AK nuk ka kalualifikuar oferten tone per pretendimin e meposhtem:*

*Ne arsyetimin e skualifikimit AK përshkruan:*

*-NË kërkesën e AK është kërkuar që ofertuesi duhet të paraqesë 8 copë printera MFP A4/A3 Color 30ppm + Set Toneri nga BOE janë ofertuar 5.*

*-NË kërkesën e AK është kërkuar që ofertuesi duhet të paraqesë 5 copë printera MFP A4/A3B&W 30ppm + Set Toneri nga BOE janë ofertuar 8.*

*Oferta ekonomike është plotësuar në kundërshtim me specifikimet teknike.*

*Autoriteti Kontraktor pretendon se ne kemi paraqitur sasi pajisjesh në kundërshtim me kërkesat e tij për shkak të gabimeve të shtypit, të cilat janë të qarta në propozimin teknik. Ne fakt, oferta*

ekonomike nuk duhet të merret si referencë teknike, por vetëm si një prezantim i artikujve, sasive dhe çmimeve.

Autoriteti duket se ka interpretuar gabimisht këto gabime të shtypit si një ndryshim në sasi të e paraqitura. Në fakt, **gabimi ishte në përdorimin e termave "BË" në vend të "color"**, por ky gabim është interpretuar nga ana e autoritetit si një gabim në sasi të e artikujve të ofruar. Ne kemi mbajtur të njëjtën renditje që ka mbajtur autoriteti në dokumentin e specifikimeve teknike (DST) për produktet e kërkuara, me të njëjtat sasi, dhe çmimet i referohen saktësisht produkteve dhe sasive përkatëse:

Artikulli i parë: Pajisje 30 ppm color (sipas specifikimeve teknike të paraqitura) – 8 cope  
Artikulli i dytë: Pajisje 30 ppm BW (sipas specifikimeve teknike të paraqitura) – 5 cope

Artikulli i tretë: Pajisje 55 ppm BW (sipas specifikimeve teknike të paraqitura) – 5 cope  
Artikulli i katërt: Software Manaxhimi (sipas specifikimeve teknike të paraqitura) – 1 cope

Nëse do të aplikojmë një logjikë analoge me atë të Autoritetit Kontraktues, mund të vërejmë se në kërkesën e tyre për "MFP A4/A3 B&W 30ppm + Set Toner - 5 copë", përdorimi i fjalës "Set" nuk është i zakonshëm për tonerat e pajisjeve bardh e zi, pasi këto pajisje zakonisht kanë vetëm një toner, jo një set tonerash siç është rasti me pajisjet me ngjyra. Kjo tregon se edhe autoriteti mund të bëjë gabime të shtypit, por kjo nuk e bën procesin të paligjshëm apo të paqartë rreth kërkesës së tij. Gabimet e tilla të shtypit nuk e bëjnë procesin të paligjshëm apo procedurën në shkelje të ligjit.

Gjithashtu AK ne ka kërkuar software per Menaxhimin e Printimit dhe license per windows server per ambientin ku do implementohet procesi. Nga ana tjetër nuk ka përmendur tek lista e produkteve që kërkon artikullin "windows server", por ne përmirësim të këtij gabimi shtypi të AK ne kemi korrigjuar këto duke qene te qarte se ofrojmë softëare per menaxhim dhe sistemin ku do implementohet, këto pjesë AK nuk e ka konsideruar lajthitje nga kërkesat e tij, por i ka pëlqyer sepse ka përmirësuar pikërisht një mangësi të AK. Prapë, këto janë gabime që nuk e bëjnë procesin të paligjshëm apo të paqarte, pasi AK ka paraqitur shume dokumente dhe shpjegime tjera që qartësojnë kërkesat e tij.

Te njëjtën gjë kemi bere dhe ne, kemi shkaktuar një gabim shtypi por nga ana tjetër kemi dhjetra dokumenta tjerë si deklarata per përmbushje të specifikimeve teknike, broshura...etj që konfirmojnë dhe qartësojnë se ne kemi ofruar mallra dhe jo shërbime, ne kemi ofruar sasite dhe produktet që AK ka përshkruar!

Nëse Autoriteti Kontraktues do të gjendej në pamundësi dhe paqartësi rreth ofertës, mund të kërkonte sqarime rreth këtyre gabimeve të shtypit dhe të merrte masat për të sqaruar paqartësitë në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me ligjin.

Neni 92 Shqyrtimi i ofertave 1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. 2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet. 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të

këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Ligji është tërësisht i qartë, dhe autoriteti duhet të kishte kërkuar sqarime për çdo gabim të shtypit apo paqartësi që mund të kishte vërejtur në ofertën tonë. Vetëm pas marrjes së sqarimeve të nevojshme, autoriteti do të kishte mundësi të nxirrte një përfundim të drejtë, të bazuar në ligj, të ndershëm, transparent dhe në përputhje me rregullat bazë të vlerësimit të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë.

Autoriteti Kontraktues, me vendimin e tij që duket të jetë në shkelje flagrante të ligjit dhe të motivuar nga interesa të tjera jo ligjore, ka shkaktuar një dëm të konsiderueshëm për buxhetin e shtetit shqiptar, i cili kap shifrën e 2,500,000 lekëve pa TVSH, ose rreth 25,000 EUR pa TVSH.

Autoriteti Kontraktor KESH, si një ndër shoqëritë publike më të rëndësishme në vend, menaxhuesi i asetëve më të mëdha të prodhimit të energjisë, sipas gjykimit tonë, duhet ti kushtojë një vëmendje të vecantë përdorimit të zgjuar të parasë, përdorimit me economicitet dhe efikasitet të parasë. Në një vend ku ligji përbën bazën dhe kufinj të veprimtarisë së shtetit, duhet që cdo qëndërkohë e parasë publike të menaxhohet duke u nisur nga parimi i economicitetit dhe efikasitetit dhe në asnjë rrethanë nuk mund të rritet kosto për taksapaguesit dhe “me një të rënë të lapsit” të harxhohen 2,500,000 lekëve pa TVSH, pa një arsyetim të qenësishëm. [...].

Legjislatori, në hartimin e ligjit për prokurimin publik, me të drejtë ka parashikuar edhe institutin e “kërkesës për sqarim” që një ent blerës i drejtohet operatorit ekonomik, për të sqaruar detaje në duke dhe në formë të paqarta, natyrisht pa ndërhyrë në elementë përmbajtësore të ofertës. I tillë është edhe rasti i ofertës së paraqitur nga BOE RIKON-AL & QuantX IT Solutions, një ofertë me devijime minore dhe sipërfaqësore dhe aspak gabime përmbajtësore. Legjislacioni, nuk e ndalon kërkesën për sqarim, por e inkurajon atë me qëllim përfitim të mirave publike në cilësinë e kërkuar me cmimin më të ulët, që tekefundit është edhe qëllimi i prokurimit publik.

Në shumë raste, Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka vënë theksin tek përdorimi me efikasitet të fondeve publike dhe konform një logjike normale prokurimi, logjikë sipas të cilës nuk mund të rëndosh arkën e shtetit vetëm vetëm sepse nuk ke shteruar dhe nuk ke dashur të shterosh të gjitha instrumentat ligjorë për qartësimin e një ofertë në një procedurë të prokurimit publik. Për sa kemi paraqitur më sipër, në dritën e fakteve, bazuar në legjislacionin përkatës, përfundimisht kërkojmë Kualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE RIKON-AL SHPK & QuantX IT Solutions SHPK.”

II.6.2. Në datën 16.05.2024, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1169/3 prot., relacioni për shqyrtimin e ankesës me nr. 2211/1 prot., datë 16.05.2024, ardhur nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, bashkëngjitur shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 2211/4 prot., datë 16.05.2024, me objekt: “Vendim për shqyrtimin e ankesës për procedurën e prokurimit me objekt: “ Blerje pajisje printimi për KESH Qendër dhe Njësitë e Prodhimit”, Nr.Ref-00117-04-04-2024”.

Referuar këtij vendimi dhe relacionit për shqyrtimin e ankesës rezulton, se autoriteti kontraktor ka refuzuar pretendimet e BOE “RIKON-AL” SHPK & “QuantX IT Solutions” SHPK, duke argumentuar si vijon:

“Në lidhje me pretendimin e ankimuesit se: Oferta ekonomike përmban gabime shtypi, të cilat në asnjë rast nuk ndryshojnë thelbin e ofertës. Këto gabime nuk sjellin asnjë konfuzion për Autoritetin Kontraktor rreth përmbajtjes së ofertës dhe për më tepër, janë plotësisht të mbështetura nga dhjetëra dokumente të tjera të paraqitura gjatë procedurës. Këto dokumente qartësisht konfirmojnë qëllimin tonë për ofertimin e mallrave, sic e dëshmojnë edhe përshkrimet e detajuara të artikujve, sasive dhe katalogëve të përfshirë në ofertë. Është e evidente dhe e dukshme se bëhet fjalë për një gabim shtypi. Vendimi i Autoritetit Kontraktor për përjashtimin e ofertës sonë shfaq një kundërshtim të hapur me Ligjin mbi Prokurimin Publik dhe, për më tepër, përbën një veprim diskriminues, i cili është përsëritur në mënyrë të qëllimshme dhe sistematike nga ana e KESH Sh.a. Oferta jonë ekonomike, sic theksoni, përmbante një listë të shërbimeve në vend të një liste mallrash. Ky gabim, megjithëse paraqet një devijim nga formati i kërkuar i ofertës, duhet vlerësuar në kontekstin e Ligjit mbi Prokurimin Publik, vecanërisht neni 92 pika 3, i cili pranon tolerancën për gabimet që nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Konsiderojmë që gabimi ynë duhet të kategorizohet si gabim shtypi dhe si devijim i vogël që mund të korrigjohet pa ndryshuar thelbin e ofertës sonë. Ligji parashikon qartë se një ofertë nuk duhet të përjashtohet nëse gabimet e tilla nuk prekin përmbajtjen substanciale të asaj që ofrohet. Ne bazë të argumenteve të paraqitura dhe të nenit përkatës të Ligjit mbi Prokurimin Publik, kërkojmë ndryshimin e vendimit dhe kualifikimin e ofertës sonë.

Në lidhje me pretendimin Tuaj sqarojmë, se Komisioni shqyrtimit të ankesave, pasi u njoh me pretendimet e ankimuesit, verifikoi dokumentacionin e paraqitur nga Bashkimi i operatorëve ekonomik “Rikon - AL” sh.p.k & “QuantX IT Solutions” sh.p.k, rezulton se ankimuesi , nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, pasi nuk ka ofertuar sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën 1 “Formulari i ofertës” dhe shtojca 2 “Lista e çmimeve të artikujve”, pjesë e dokumenteve të tenderit. Shtojca 1 “Formulari i ofertës” dhe shtojca 2 “Lista e çmimeve të artikujve”, paraqitur nga ky bashkim operatorësh nuk janë sipas formatit të kërkuar në DST të tenderit për këtë procedurë prokurimi, pasi shtojcat e paraqitura janë për shërbim, ndërkohë që procedura e prokurimit është mall. Sqarojmë se subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, ofertues i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, bazuar në Seksioni 1 në DST : “Udhëzime për operatorët ekonomikë” në pikat 4, 6 dhe 10 përcaktohet se:

#### 4. Formularët e tenderit dhe Listat Cmimeve

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.

#### 6. Cmimet

1. Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuar në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit.

2. *Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkëngjitur me këto DT, duke përcaktuar mallrat që do të dorëzohen, sasi të dhe çmimin e tyre.*
3. *Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në valutë të huaj siç përcaktohet në Njoftimin e Kontratës, atëherë ato duhet të konvertohen në Lekë shqiptare (Lekë) sipas kursit të këmbimit të caktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.*
4. *Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjitha Mallrat pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.*

*Në rastin e një Marrëveshjeje Kuadër ku NUK përcaktohen të gjitha kushtet, çmimet për kontratat bazuar në Marrëveshjen Kuadër nuk janë të fiksuara, ato janë objekt i ndryshimit pas një mini – konkurrimit midis Operatorëve Ekonomikë, palë në Marrëveshjen Kuadër.*

#### 10. Formati dhe Nënshkrimi i Ofertave

*Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, çdo Operator Ekonomik paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT. Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim.*

*Për sa referoni në ankesën Tuaj se përse nuk është marrë për bazë neni 92 i ligjit Nr.162 datë 23/12/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar ku citohet: [...]*

*Neni 92*

#### **Shqyrtimi i ofertave**

*1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.*

*2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.*

*3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*

*Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.*

*Gjithashtu bazuar në Seksionin I në DST: “Udhëzime për operatorët ekonomikë”,*



gërma E SHQYRTIMI I OFERTAVE, pika 14 Sqarimi i ofertave citohet se:

1. Autoriteti/Enti Kontraktor, gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, mund të kërkojë sqarime nga operatorët ekonomikë ofertues. Çdo sqarim i paraqitur nga Operatori Ekonomik që nuk i përgjigjet një kërkesë nga Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të merret në konsideratë. Nuk mund të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në çmimet ose përmbajtjen e ofertave, përveç rasteve të konfirmimit të korrigjimit të gabimeve aritmetike të konstatuara nga Autoriteti/Enti Kontraktor gjatë vlerësimit të ofertave.

Pra është e percaktuar qarte që nuk mund lejohet asnjë ndryshim në çmimet ose përmbajtjen e ofertave përveç rasteve të konfirmimit të korrigjimit të gabimeve aritmetike të konstatuara nga Autoriteti/Enti Kontraktor gjatë vlerësimit të ofertave. Në këtë rast kjo ofertë nuk ka patur gabime aritmetike, pasi ky bashkim operatorësh ka paraqitur formular oferte sipas DST shërbime si dhe Lista e çmimeve të shërbimeve ndërkohë që procedura është procedurë mallrash.

Për sa me sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Në lidhje me pretendimin e dytë të ankimuesit se AK, pretendon se ne kemi paraqitur sasi pajisjesh në kundërshtim me kërkesat e tij, për shkak të gabimeve të shtypit, të cilat janë të qarta në propozimin teknik. Në fakt oferta ekonomike nuk duhet të merret si referencë teknike, por vetëm si prezantim i artikujve sasive dhe çmimeve dhe se AK ka interpretuar gabimisht këto gabime të shtypit si një ndryshim në sasi të paraqitura. Në fakt, gabimi ishte në përdorimin e termave "BË" në vend të "color", por ky gabim është interpretuar nga ana e autoritetit si një gabim në sasi të artikujve të ofruar. Ne kemi mbajtur të njëjtën renditje që ka mbajtur autoriteti në dokumentin e specifikimeve teknike (DST) për produktet e kërkuara, me të njëjtat sasi, dhe çmimet i referohen saktësisht produkteve dhe sasive përkatëse:

Komisioni shqyrtimit të ankesave, pasi u njoh me pretendimet e ankimuesit, sqaron se:

1- Oferta e paraqitur nga ankimuesi, nuk është një gabim shtypi, pasi shtojca 1 "Formulari i ofertës" dhe shtojca 2 "Lista e çmimeve të artikujve", nuk janë plotësuar sipas formatit të kërkuar në DST për këtë procedurë prokurimi, pasi kemi të bëjmë me DST për mallra dhe jo shërbim ashtu sic ka ofertuar ankimuesi.

2- Në kërkesën e Autoritetit Kontraktor është kërkuar që ofertuesi duhet të paraqesë:

8 (tetë) copë printera MFP A4/A3 Color 30ppm + Set Toneri.

5 (pesë) copë printera MFP A4/A3B&W 30ppm \* Set Toneri

5 (pesë) copë printera MFP A4/A3 B&W55ppm \* Set Tone

1 (një) copë Softëare Manaxhimi.

Ndërkohë referuar formularit të ofertës së paraqitur nga ankimuesi janë ofertuar:

5 (pesë) copë printera MFP A4/A3 Color 30ppm + Set Toneri.

8 (tetë) copë printera MFP A4/A3B&W 30ppm + Set Toneri

5 (pesë) copë printera MFP A4/A3 B&W 55ppm + Set Tone

1 (një) copë Software Manaxhimi.

Sqarojme se subjekti i pare i interesuar ishte operatari ekonomik, ofertues i cili e pergatit oferten e tij ne perputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor ne fuqi, dhe nga ana tjetir, eshte

autoriteti kontraktor i cili perzgjedh operatorin ekonomik qe ploteson te gjitha kriteret e percaktuara nga autoriteti kontraktar ne dokumentet e tenderit, si dhe qe ka pergatitur oferten ne perputhje me kerkesat e dokumenteve te tenderit dhe legjislacionin ne fuqi. Ne kete rast kjo oferte nuk ka patur gabime aritmetikore, pasi ky bashkim operatoresh ka paraqitur formular oferte sipas DST sherbime si dhe Lista e qmiieneve te sherbimeve nderkohe qe procedura eshte procedure mallrash. Gjithashtu edhe Lista e cmimeve nuk eshte paraqitur sipas sasive te kerkuara ne DST, pasi jane bere ndryshime ne sasi dhe pershkrimin e mallit te kerkuar.

Bazuar në Seksionin 1: “Udhëzime për operatorët ekonomikë” në pikat 4, 6 dhe 10 përcaktohet se:

#### 4. Formularit e tenderit dhe Listat e Cmimeve

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqëruar duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.

Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të nuirierizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme dhe të printuar duhet të pajisen ne inicialet ose të nënshkruhen nga Personi (at) e Autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i nënshkruar nga Personat e Autorizuar.

#### 6. Cmimet

1. Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës do të jenë në përputhje me kerkesat e specifikuar në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit.
2. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkëngjitur me këto DT, du ke përcaktuar mallrat që do të dorëzohen, sasi të dhe çmimin e tyre.
3. Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në valutë të huaj siç përcaktohet në Njoftimin e Kontratës, atëherë ato duhet të konvertohen në Lekë shqiptare (Lekë) sipas kursit të këmbimit të caktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.
4. Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjitha Mallrat pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.

Në rastin e një Marrëveshje Kuadër ku NUK përcaktohen të gjitha kushtet, çmimet për kontratat bazuar në Marrëveshjen Kuadër nuk janë të fiksuara, ato janë objekt i ndryshimit pas një mini konkurrimi midis Operatorëve Ekonomikë, palë në Marrëveshjen Kuadër.

#### 10. Formati dhe Nënshkrimi i Ofertave

Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, cdo Operator Ekonomik paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT. Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim.

Për sa më sipër pretendimi i ankimesit nuk qëndron.

Në lidhje me pretendimet Tuaja se nga ana e autoritetit kontraktor janë bërë lapsuse, në specifikimet teknike, sqarojmë se këto pretendime duhet te ishin paraqitur gjatë afateve të përcaktuara në Ligjin Nr.162 datë 23/12/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe VKM Nr.285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Gjithashtu, sqarojmë se referuar kërkesës së bërë në sistemin e prokurimit elektronik në datë 09/04/2024, nga operatori ekonomik “Rikon - AL” sh.p.k, nuk janë paraqitur këto pretendime.”

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK se: *Operatori Ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k, NIPT J61817047D ka paraqitur ofertë ekonomike anomalisht të ulët. Në zbatim të nenit 93 pika 5 të ligjit Nr.162 datë 23/12/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar citohet se: 5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 93 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”

III.1.2. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:*

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.
- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.
- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.1.3. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, konstatohet, se oferta ekonomike në vlerën prej 7.497.000 lekë pa TVSh, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 dhe 5 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim. Mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të *lex specialis*.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit.

Në rastin konkret, në zbatim të pikës 5 të nenit 93 të LPP-së se: *në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët*”, procedura e prokurimit objekt - shqyrtimi “Blerje pajisje printimi për KESH Qendër dhe Njësitë e Prodhimit”, e ka fondin limit 15,000,000 lekë, vlerë e cila rezulton nën kufirin e lartë monetar, referuar nenit 11 të VKM-së nr.285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku thuhet se: Në përputhje me nenin 33, të LPP-së, kufijtë monetarë janë:

a) Kufiri i lartë monetar:

- 650 000 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;
- 40 000 000 (dyzet milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

b) Kufiri i ulët monetar:

- 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;
- 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se vendimi i KVO-së për refuzimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK është i drejtë, pasi ndryshimet e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kanë hyrë në fuqi pas datës 20.03.2024, ndërkohë që urdhri i prokurimit për procedurën e mësipërme të prokurimit mban datën 03.04.2024, ndaj për procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, siç është rasti në fjalë, autoriteti kontraktor e refuzon ofertën e cila është konstatuar anomalisht e ulët pa kërkuar shpjegime.

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me arsyet e skualifikimit të BOE “RIKON-AL” SHPK & “QuantX IT Solutions” SHPK se: “Bashkimi i operatorëve ekonomik “Rikon - AL” sh.p.k, NIPT L22119010H (90%) & “QuantX IT Solutions” sh.p.k, NIPT M31904013D (10%) pasi:

✚ *Formulari i ofertës i paraqitur nga bashkimi operatorëve ekonomik “Rikon – AL” sh.p.k, NIPT L22119010H (90%) & “QuantX IT Solutions” sh.p.k, është në kundërshtim me dokumentat e tenderit. Është paraqitur formular oferte sipas DST shërbime si dhe Lista e çmimeve të shërbimeve ndërkohë që procedura është procedurë mallrash.*

✚ *Në kërkesën e Autoritetit Kontraktor është kërkuar që ofertuesi duhet të paraqesë 8 (tetë) copë printera MFP A4/A3 Color 30ppm + Set Toneri. Nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Rikon - AL” sh.p.k & “QuantX IT Solutions” sh.p.k, janë ofertuar 5 (pesë) copë printera. Oferta ekonomike është plotësuar në kundërshtim me specifikimet teknike.*

✚ *Në kërkesën e Autoritetit Kontraktor është kërkuar që ofertuesi duhet të paraqesë 5 (pesë) copë printera MFP A4/A3B&Ë 30ppm + Set Toneri. Nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Rikon - AL” sh.p.k & “QuantX IT Solutions” sh.p.k, janë ofertuar 8 (tetë) copë printera. Oferta ekonomike është plotësuar në kundërshtim me specifikimet teknike.*

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 1 dhe 2 të dokumenteve të tenderit për procedurën e mësipërme të prokurimit, është parashikuar si më poshtë vijon:

Shtojca 1.

*(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)*

### **FORMULARI I OFERTËS**

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): \_\_\_\_\_

Monedha: \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

#### Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	6
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Njësi	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total për artikull (4 x 5X)
1.					
2.					
3.					
4.					
<b>Çmimi total (Mallrat)</b>					_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					
<b>Datë</b> _____					

📌 Referohuni në dokumentacionin e ngarkuar në SPE, bashkëlidhur DST-ve.

Në shtojcën mbi termat e referencës të publikuara në SPE është parashikuar si vijon:

## 6. SPECIFIKIMET TEKNIKE

### 6.1. Nevojat, specifikimet e SMP

Sasitë dhe shpërndarja e pajisjeve

Për të realizuar sistemin e shërbimit të printimit/fotokopjimit dhe skanimin kërkohet sasia e mëposhtme e pajisjeve:

Nr	Përshkrimi	Sasia
1	A4/A3 Color 30ppm	8
2	A4/A3 B&W 30ppm	5
3	A4/A3 B&W 55ppm	5



## 6.4. Kërkesa të përgjithshme për pajisjet

Modeli	Njesia	Sasia	Total Vlera
MFP A4/A3 Color 30ppm + Set Toneri	Cope	8	
MFP A4/A3 B&W 30ppm + Set Toner	Cope	5	
MFP A4/A3 B&W 55ppm + Set Toner	Cope	5	
Software Manaxhimi	Cope	1	
Totali Pa TVSH			
TVSH			
Totali me TVSH			

III.2.2. Nga verifikimi i ofertës ekonomike të BOE “RIKON-AL” SHPK & “QuantX IT Solutions” SHPK rezulton, se është ofruar si vijon:

Shtojca 2.

### LISTA E ÇMIMEVE TË SHERBIMEVE

Data: 22/04/2024

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: REF- 00117-04-04-2024

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): BOE RIKON-AL shpk L22119010H & QuantX IT Solutions shpk M31904013D

**Monedha: Lek**

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Sherbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për sherbimet. Sherbimet pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

#### Lista e Çmimeve

1	2	3	4	6
Sherbimi	Përshkrimi i sherbimit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për sherbim (3 x 4X)
1	MFP A4/A3 B&W 30ppm + Set Toner	8		
2	MFP A4/A3 Color 30ppm + Set Toneri	5		
3	MFP A4/A3 B&W 55ppm + Set Toner	5		
4	Software Manaxhimi + WIN Server	1		
Çmimi total (Mallrat)				
Çmimi Neto pa TVSH				
TVSH (%)				
Çmimi total me TVSH:				
Emri i përfunduesit BOE RIKON-AL shpk				

III.2.3. Në ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik, BOE “RIKON-AL” SHPK & “QuantX IT Solutions” SHPK argumenton se:

“Pretendimi i Pare Oferta e jone nuk eshte kualifikuar per gabime shtypi! Ne arsyetimin e tij AK nuk ka kualifikuar oferten tone per pretendimin e meposhtem:

-Formulari i ofertës i paraqitur nga BOE Rikon-AL sh.p.k L22119010H (90%) & quantx IT Solutions sh.p.k (10%) M31904013D është në kundërshtim me dokumentet e tenderit. Eshtë paraqitur formular oferte sipas DT shërbime si dhe Lista e Cmimeve të shërbimeve ndërkohë që procedura është procedurë mallrash.

Oferta ekonomike e paraqitur nga ana jone si me poshtë:

Shtojca 2.

LISTA E ÇMIMEVE TË SHERBIMEVE

Data: 22/04/2024

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: REF- 00117-04-04-2024

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): BOE RIKON-AL shpk L22119010H & QuantX IT Solutions shpk M31904013D

Monedha: Lek

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Sherbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për sherbimet. Sherbimet pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	6
Sherbimi	<u>Përshkrimi i sherbimit</u>	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për sherbim (3 x 4X)
1	MFP A4/A3 B&Ë 30ppm + Set Toner	8		
2	MFP A4/A3 Color 30ppm + Set Toneri	5		
3	MFP A4/A3 B&Ë 55ppm + Set Toner	5		
4	Softëare Manaxhimi + ËIN Server	1		
<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>				
<b>TVSH (%)</b>				
<b>Çmimi total me TVSH:</b>				
<b>Emri i përfaqësuesit BOE RIKON-AL shpk L22119010H &amp; QuantX IT Solutions shpk M31904013D</b>		<b>AGON MAKOLLI</b>		
<b>Vula</b>				
<b>Datë 22/04/2024</b>				

Oferta ekonomike përmban gabime shtypi, të cilat në asnjë rast nuk ndryshojnë thelbin e ofertës. Këto gabime nuk sjellin asnjë konfuzion për Autoritetin Kontraktor rreth përmbajtjes së ofertës dhe për më tepër, janë plotësisht të mbështetura nga dhjetëra dokumente të tjera të paraqitura gjatë procedurës. Këto dokumente qartësisht konfirmojnë qëllimin tonë për ofertimin e mallrave,

sic e dëshmojnë edhe përshkrimet e detajuara të artikujve, sasive dhe katalogëve të përfshirë në ofertë. Është evidente dhe e dukshme se bëhet fjalë për një gabim shtypi. Vendimi i Autoritetit Kontraktor për përjashtimin e ofertës sonë shfaq një kundërshtim të hapur me Ligjin mbi Prokurimin Publik dhe, për më tepër, përbën një veprim diskriminues, i cili është përsëritur në mënyrë të qëllimshme dhe sistematike nga ana e KESH Sh.a.

Oferta jonë ekonomike, sic theksoni, përmbante një listë të shërbimeve në vend të një liste mallrash. Ky gabim, megjithëse paraqet një devijim nga formati i kërkuar i ofertës, duhet vlerësuar në kontekstin e Ligjit mbi Prokurimin Publik, vecanërisht nën 92 pika 3, i cili pranon tolerancën për gabimet që nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Konsiderojmë që gabimi ynë duhet të kategorizohet si gabim shtypi dhe si devijim i vogël që mund të korrigojë pa ndryshuar thelbin e ofertës sonë. Ligji parashikon qartë se një ofertë nuk duhet të përjashtohet nëse gabimet e tilla nuk prekin përmbajtjen substanciale të asaj që ofrohet. Ne bazë të argumenteve të paraqitura dhe të nenit përkatës të Ligjit mbi Prokurimin Publik, kërkojmë ndryshimin e vendimit dhe kualifikimin e ofertës sonë!

### **Pretendimi i dyte.**

Oferta e jone nuk eshte kualifikuar per gabime shtypi dhe jo substanciale!

Ne arsyetimin e tij AK nuk ka kalualifikuar oferten tone per pretendimin e meposhtem:

Ne arsyetimin e skualifikimit AK përshkruan:

-Në kërkesën e AK është kërkuar që ofertuesi duhet të paraqesë 8 copë printera MFP A4/A3 Color 30ppm + Set Toneri nga BOE janë ofertuar 5.

-Në kërkesën e AK është kërkuar që ofertuesi duhet të paraqesë 5 copë printera MFP A4/A3B&W 30ppm + Set Toneri nga BOE janë ofertuar 8.

Oferta ekonomike është plotësuar në kundërshtim me specifikimet teknike.

Autoriteti Kontraktor pretendon se ne kemi paraqitur sasi pajisjesh në kundërshtim me kërkesat e tij për shkak të gabimeve të shtypit, të cilat janë të qarta në propozimin teknik. Ne fakt, oferta ekonomike nuk duhet të merret si referencë teknike, por vetëm si një prezantim i artikujve, sasive dhe çmimeve.

Autoriteti duket se ka interpretuar gabimisht këto gabime të shtypit si një ndryshim në sasi të paraqitura. Në fakt, gabimi ishte në përdorimin e termave "BW" në vend të "color", por ky gabim është interpretuar nga ana e autoritetit si një gabim në sasi të artikujve të ofruar. Ne kemi mbajtur të njëjtën renditje që ka mbajtur autoriteti në dokumentin e specifikimeve teknike (DST) për produktet e kërkuara, me të njëjtat sasi, dhe çmimet i referohen saktësisht produkteve dhe sasive përkatëse:

Artikulli i parë: Pajisje 30 ppm color (sipas specifikimeve teknike të paraqitura) – 8 cope Artikulli i dytë: Pajisje 30 ppm BW (sipas specifikimeve teknike të paraqitura) – 5 cope

Artikulli i tretë: Pajisje 55 ppm BW (sipas specifikimeve teknike të paraqitura) – 5 cope Artikulli i katërt: Software Menaxhimi (sipas specifikimeve teknike të paraqitura) – 1 cope

Nëse do të aplikojmë një logjikë analoge me atë të Autoritetit Kontraktues, mund të vërejmë se në kërkesën e tyre për "MFP A4/A3 B&W 30ppm + Set Toner - 5 copë", përdorimi i fjalës "Set" nuk është i zakonshëm për tonerat e pajisjeve bardh e zi, pasi këto pajisje zakonisht kanë vetëm një toner, jo një set tonerash siç është rasti me pajisjet me ngjyra. Kjo tregon se edhe autoriteti mund të bëjë gabime të shtypit, por kjo nuk e bën procesin të paligjshëm apo të paqartë rreth kërkesës së tij. Gabimet e tilla të shtypit nuk e bëjnë procesin të paligjshëm apo procedurën në shkelje të ligjit.

Gjithashtu AK ne ka kërkuar software per Menaxhimin e Printimit dhe license per ëindoës server per ambientin ku do implementohet procesi. Nga ana tjetër nuk ka përmendur tek lista e produkteve qe kërkon artikullin “windows server”, por ne përmirësim te këtij gabimi shtypi te AK ne kemi korrigjuar kete duke qene te qarte se ofrojmë softëare per menaxhim dhe sistemin ku do implementohet, kete pjese AK nuk e ka konsideruar lajthitje nga kërkesat e tij, por i ka pëlqyer sepse ka përmirësuar pikërisht nje mangësi te AK. Prape, këto janë gabime qe nuk e bëjnë procesin te paligjshëm apo te paqarte, pasi AK ka paraqitur shume dokumenta dhe shpjegime tjera qe qartësojnë kërkesat e tij.

Te njëjtën gje kemi bere dhe ne, kemi shkaktuar nje gabim shtypi por nga ana tjetër kemi dhjetra dokumenta tjerë si deklarata per përmbushje te specifikimeve teknike, broshura...etj qe konfirmojnë dhe qartësojnë se ne kemi ofruar mallra dhe jo shërbime, ne kemi ofruar sasite dhe produktet qe AK ka përshkruar!

Nëse Autoriteti Kontraktues do të gjendej në pamundësi dhe paqartësi rreth ofertës, mund të kërkonte sqarime rreth këtyre gabimeve të shtypit dhe të merrte masat për të sqaruar paqartësitë në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me ligjin.

Neni 92 Shqyrtimi i ofertave 1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. 2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet. 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Ligji është tërësisht i qartë, dhe autoriteti duhet të kishte kërkuar sqarime për çdo gabim të shtypit apo paqartësi që mund të kishte vërejtur në ofertën tonë. Vetëm pas marrjes së sqarimeve të nevojshme, autoriteti do të kishte mundësi të nxirrte një përfundim të drejtë, të bazuar në ligj, të ndershëm, transparent dhe në përputhje me rregullat bazë të vlerësimit të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë.

Autoriteti Kontraktues, me vendimin e tij që duket të jetë në shkelje flagrante të ligjit dhe të motivuar nga interesa të tjera jo ligjore, ka shkaktuar një dëm të konsiderueshëm për buxhetin e shtetit shqiptar, i cili kap shifrën e 2,500,000 lekëve pa TVSH, ose rreth 25,000 EUR pa TVSH.

Autoriteti Kontraktor KESH, si një ndër shoqëritë publike më të rëndësishme në vend, menaxhuesi i aseteve më të mëdha të prodhimit të energjisë, sipas gjykimit tonë, duhet ti kushtojë një vëmendje të vecantë përdorimit të zgjuar të parasë, përdorimit me ekonomicitet dhe eficientë të parasë. Në një vend ku ligji përbën bazën dhe kufinj të veprimtarisë së shtetit, duhet që cdo qindarkë e parasë publike të menaxhohet duke u nisur nga parimi i ekonomicitetit dhe eficientë dhe në asnjë

rrethanë nuk mund të rritet kosto për taksapaguesit dhe “me një të rënë të lapsit” të harxhohen 2,500,000 lekëve pa TVSH, pa një arsyetim të qenësishëm. [...].

Legjislatori, në hartimin e ligjit për prokurimin publik, me të drejtë ka parashikuar edhe institutin e “kërkesës për sqarim” që një ent blerës i drejtohet operatorit ekonomik, për të sqaruar detaje në duke dhe në formë të paqarta, natyrisht pa ndërhyrë në elementë përmbajtësore të ofertës. I tillë është edhe rasti i ofertës së paraqitur nga BOE RIKON-AL & QuantX IT Solutions, një ofertë me devijime minore dhe sipërfaqësore dhe aspak gabime përmbajtësore. Legjislacioni, nuk e ndalon kërkesën për sqarim, por e inkurajon atë me qëllim përfitimin e të mirave publike në cilësinë e kërkuar me cmimin më të ulët, që tekefundit është edhe qëllimi i prokurimit publik.

Në shumë raste, Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka vënë theksion tek përdorimi me efikasitet të fondeve publike dhe konform një logjike normale prokurimi, logjikë sipas të cilës nuk mund të rëndosh arkën e shtetit vetëm vetëm sepse nuk ke shteruar dhe nuk ke dashur të shterosh të gjitha instrumentat ligjorë për qartësimin e një ofertë në një procedurë të prokurimit publik. Për sa kemi paraqitur më sipër, në dritën e fakteve, bazuar në legjislacionin përkatës, përfundimisht kërkojmë Kualifikimin e ofertës se paraqitur nga BOE RIKON-AL SHPK & QuantX IT Solutions SHPK.”[...].”

III.2.4. Në nenin 2 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.2.5. Në nenin 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.6. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

III.2.7. Në nenin 91 “Ndalimi i modifikimit të ofertave”, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Pas afatit përfundimtar për hapjen e ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit ose entit kontraktor dhe ofertuesit për vlerën e ofertës, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.
2. Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t'i kërkohet që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdolloj mënyre ofertën.
3. Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë zbatimin e neneve 44, 45, 46 dhe 47 të këtij ligji.

Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.
2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.
3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.2.8. KPP thekson, se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, është ai bazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Me marrjen pjesë në procedurën e prokurimit, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. KPP gjykon, se zbatimi i parimit të transparencës, bazisë, dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime, ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion të barabartë, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur vlerësohen ato.

III.2.9. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, BOE “RIKON-AL” SHPK & “QuantX IT Solutions” SHPK ka paraqitur Shtojcën 2 me emërtimin “Lista e çmimeve të shërbimeve”, pjesë e ofertës së tij, ndërkohë që objekti i prokurimit është blerje pajisjesh, gjë e cila gjen pasqyrim edhe në shtojcën 2 “Lista e çmimeve të mallrave”, të dokumenteve të tenderit të publikuara në SPE. Pra emërtimi i shtojcës mbi çmimet e ofruara është për shërbime, ndërkohë që AK ka kërkuar nga subjektet ofrimin e mallrave.

Gjithashtu, rezulton se, në gjurmën “c” dhe “d” të shtojcës 1 “Formulari i Ofertës”, operatori ekonomik ankimues ka deklaruar se: “c)Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor



*[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për [vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE] në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit. d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme: 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë; 2. Njoftimin e Kontrates; 3. Kriteret e Përzgjedhjes; 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvritimit dhe sasinë e kërkuar; 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës; 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës; 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.”*

Ndërkohë nga shqyrtimi i formularit të ofertës dhe listës së çmimeve të ofruara nga BOE “RIKON-AL” SHPK & “QuantX IT Solutions” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, konstatohet, se ankimuesi ka ndryshuar sasinë e mallit, duke ofruar 8 copë MFP A4/A3 B&W 30 ppm+ Set Toner, nga 5 copë të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe ka ndryshuar sasinë e mallit lidhur me produktin MFP A4/A3 Color 30 ppm+ Set Toneri, duke ofruar 5 copë nga 8 të kërkuara nga AK, për më tepër që edhe çmimet e ofruara për këto artikuj janë të ndryshme.

Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, thuhet shprehimisht se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë: “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit; “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë”, ndaj ndryshimi i sasive të mallit të ofruar nga ankimuesi nga sasinë e kërkuara nga AK është shmangie e ofertuesit nga kërkesat dhe nevojat e autoritetit kontraktor të specifikuara në dokumentet e tenderit.

KPP thekson, se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Me marrjen pjesë në procedurën e prokurimit, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. KPP gjykon, se zbatimi i parimit të transparencës barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime, ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion të barabartë, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur vlerësohen ato. Në rastin konkret Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se BOE “RIKON-AL” SHPK & “QuantX IT Solutions” SHPK, ka ndryshuar sasinë e mallrave të kërkuar nga autoriteti kontraktor. Komisioni gjykon, se nuk jemi në kushtet e mospërputhjes së çmimit për njësi me çmimin total (gabim aritmetik), apo mospërputhjes ndërmjet fjalëve dhe shifrave, të parashikuara në nenin 82, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,



i ndryshuar, por jemi në kushtet e ndërhyrjes në sasi të mallit të kërkuar. Neni 92 i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, përcakton qartë, se nga ana e autoritetit kontraktor nuk mund të lejohet ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se me ndryshimet e kryera në listën e cmimeve, oferta e paraqitur nga BOE “RIKON-AL” SHPK & “QuantX IT Solutions” SHPK SHPK ka pasaktësi thelbësore, çka e bën atë të pavlefshme.

KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi.

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimet e BOE “RIKON-AL” SHPK & “QuantX IT Solutions” SHPK, për sa i përket hartimit të dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

“Në nenin 110, pikat 1, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë. 7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

Në nenin 111, pika 1, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për kundërshtimin e dokumenteve të

tenderit, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës dhe 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik pas afatit të parashikuar nga neni 110, pika 1 e Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kundër dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit, nis ditën e publikimit të njoftimit të kontratës dhe përfundon ditën e shtatë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, për dokumentet e tenderit, nuk kanë përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e tyre nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-00117-04-04-2024, me objekt: “Blerje pajisje printimi për KESH Qendër dhe Njësitë e Prodhimit” me fond limit 15,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 22.04.2024, nga autoriteti kontraktor, KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitiko Shqiptare).
2. Të mos pranojë ankesën e BOE “RIKON-AL” SHPK & “QuantX IT Solutions” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, sipas legjislacionit të prokurimit publik.

4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK.
5. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga BOE “RIKON-AL” SHPK & “QuantX IT Solutions” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**

